

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Magjistratët na treguan se problemi i Shqipërisë janë vetë ata. Rama e dinte!
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/09/14/magjistratet-na-treguan-se-problemi-i-shqiperise-jane-vete-ata-rama-e-dinte/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 07:04:16 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 06:56:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	6b60aa6f254f926f0a2c528835242e9af49d57dec43ea7e3cabd1c32ef5ab529
TEKSTI	f072a2c03cf67554b5cefe4cde1f8601e82c1a049ce8e921da53a07fa0e1a8bd
PAMJA	7aee9e437e759d533edb9144df4075f4e0236a030d3d424766eb682bc8699eb7

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	79302a4962c583017df4dfdf02d4654dc481dd8b5481dda64d36538b90aaaebc
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7f30966000672975708e7c492689d739f9d4667f12adc4270686e28ed502fc27
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/79302a4962c583017df4dfdf02d4654dc481dd8b5481dda64d36538b90aaaebc>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Magjistratët na treguan se problemi i Shqipërisë janë vetë ata. Rama e dinte!

Analizë

Publikuar: 14/09/2026

f X



Nga Albatros Rexhaj

Në Shqipëri një qytetar mund të presë vite që gjykata t'i japë të drejtë. Gjykata Administrative e Apelit e mbylli vitin 2024 me 23,862 çështje në pritje. Pas atij numri ka prona, vende pune, pensione, detyrime të administratës dhe vite jete të ngrira në një dosje. Shpjegimi është gjithmonë i njëjti: dosje shumë, gjyqtarë pak.

Pastaj erdhi paga e gjyqtarëve. Padia u depozitua më 11 shtator. Masa e sigurimit u dha po atë ditë. Koha u gjet.

Qytetari pret vite. Ata pritën një ditë. Dhe pikërisht këtu vonesa e Kuvendit bëri një shërbim që askush nuk e kishte planifikuar. Sikur ligji të ishte miratuar në kohë, ndoshta nuk do ta kishim parë kurrë deri ku shkon instinkti i këtij sistemi kur vjen puna te vetja.

Erion Braçe tha se Kuvendi duhej të kishte vendosur brenda 31 korrikut, dhe e tha si faj. Nuk është faj. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm kur vdes një ligj; kur mblidhet Kuvendi e vendos Kuvendi. Askush nuk e urdhëron dot parlamentin të votojë; kur vonon, e ndëshkojnë votuesit, jo prokurori. Për pagat Gjykata tha një gjë të vetme: caktohen me ligj. Ligjin e bën Kuvendi. Kuvendi vonoi. Kompetenca nuk kaloi automatikisht te dikush tjetër, dhe vonesa nuk e bëri KLGJ-në Kuvend.

KLGJ-ja nuk priti. Më 26 gusht e ngriti vetë pagën referuese nga 156,825 në 222,425 lekë, plus 14,000 për kualifikim. Urdhëroi edhe rillogaritjen e efektit financiar që nga prilli 2023. Qeveria i përlllogarit këto prapambetje në rreth 12 miliardë lekë. Kur

Me te lexuarat

Rama "djeg" Allajbeun, i heq tenderin 50 milionë euro për sterilizimin në minutat e përcaktuara. Rama në...

Arbitrazh: Po na merr aeroportin e Vlorës për t'ia dhënë...

Besnik Leskaj pas pasurisë së re. Besnik Leskaj pas pasurisë së re. Besnik Leskaj pas pasurisë së re...

Administratë e vjetër: si lind ASHP-ja me gjysmën e ATP-së akoma gjallë brenda...

Kukalajt në OSHISH, Spahiu i përgjigjet kritikave: Menaxhere shumë e mirë, opozit...

Thesari refuzoi, magjistratët nuk pritën as aty. Shkuan te prokurori. Kallëzuan ministrin e Financave, sekretarin e përgjithshëm dhe drejtuesit e degëve të Thesarit. Pastaj paga e tyre shkoi në gjykatë, dhe gjykata vendosi brenda ditës. Gjyqtarët e paktë, arsyeja që na jepet për çdo vonesë, nuk zgjedhin dosje.

Kur gjykata vonon, zyrtari nuk ka frikë. Kur zyrtari nuk ka frikë, qytetari kërkon mik. Kur miku nuk mjafton, hyn ndërmjetësi. Pastaj hyn leku, jo vetëm për të blerë vendimin, edhe për të hyrë në radhë. Kështu vonesa e gjykatës bëhet mënyra si funksionon shteti. Gjukata është institucioni që duhet t'i ndreqë të gjithë të tjerët. Politikanin, nëpunësin, pronarin. Kur nuk punon ajo, të gjithë të tjerët mësojnë se mund të mos punojnë. Prandaj, kur kërkoj arsyen pse besimi te institucionet publike në Shqipëri është kaq i ulët, unë magjistraturën e vë të parën. Politikës i vjen radha pas saj. E di që tani është bërë modë: Rama në burg, Berisha në burg, përgjegjësi kërkohet vetëm nga politika dhe kush e kërkon quhet i pavarur. Por kjo histori na çon te gjeneza e problemeve të këtij vendi: gjykata dhe prokurori që zvarrisin, që e bëjnë qytetarin të kërkojë mik e ndërmjetës, dhe që tani duan edhe paga si në filma. Politikani i keq duhet të ketë frikë nga gjykata, dhe sot ka. Problemi i Shqipërisë është se gjykatësi që nuk gjykon nuk ka pasur kurrë frikë nga askush.

Ata jetojnë mbi këtë sistem. Koston e tij e paguajnë të tjerët, me vite nga jeta. Dhe tani kërkojnë të paguhet për të më shumë se të gjithë, më shumë se Presidenti i Republikës. Prandaj po: Ilupës.

Rama këtë e dinte, dhe nuk e kam fjalën vetëm për pagat. Për vite politika u ul në bankën e të akuzuarit dhe magjistratura në karrigen që jep verdiktin: politikanët duheshin hetuar dhe arrestuar, drejtësia duhej financuar dhe lënë e qetë. Një ndarje e rehatshme, deri ditën kur magjistratët duhej të tregonin si sillen kur interesi është i tyre. Nuk mund ta provoj çfarë mendonte Rama, por mund të shoh çfarë kishte përpara. Më 30 korrik, një ditë para skadimit të afatit, dy deputetë socialistë, Aulona Bylykbashi dhe Admir Kadeli, kishin një zgjidhje mbi tavolinë: koeficientin nga 0.36 në 0.38. Kuvendi nuk e votoi. Pastaj ndodhi gjithçka që lexuat më lart, dhe Rama doli me shifrat. Me tabelat, me kursin e Bankës së Shqipërisë të datës 11 shtator, me datën e seancës. Kush zihet në befasi nuk i ka të gjitha këto gati brenda fundjavës. Rama ishte përgatitur të luftonte këtë betejë. Magjistratët thjesht ia dhanë materialin.

Më 10 shtator Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve paralajmëroi se konflikti mund të çohet te Komisioni Europian dhe te përfaqësitë diplomatike të huaja. Paralajmëroi edhe kufizimin e punës së gjykatave vetëm në çështjet urgjente. Një pushtet i Republikës, në konflikt me dy pushtetet e tjera të Republikës, rendit ambasadat si adresë. Kur politika ua kundërshton

interesin, arbitrin e kërkojnë jashtë shtetit shqiptar. “Kushtetuta nuk negociohet”, thanë. Pajtohem. Nuk negociohet as në ambasada.

Kryeministri ka të drejtë për thesarin. Ka të drejtë edhe për sirtarët. Dhe po, unë do ta shtyja ligjin edhe një seancë, që Kuvendi t’u kujtojë të gjithëve se është Kuvend, dhe se datën nuk ia caktojnë as Këshillat, as prokurori, as ambasadat. Pastaj le ta votojë, dhe le ta votojë pa kërkuar falje. Këto javë magjistratura nuk ndryshoi; vetëm u zbulua. Pa atë vonesë nuk do ta kishim parë kaq qartë se çfarë ndodh kur njerëzit që na mbajnë ne në radhë, për një herë, duhet të presin vetë.

TAG:

Albatros rexhaj

Të ngjashme

Kur pushteti politik abdikon ndaj atij gjyqësor

John Goci konkurren Donald Trump, sa do të shkojë ankandi?

Demokracia jonë pa hardware dhe software?!

Prapaskena

‘Prapaskena’ lindi si një nismë e një grupi gazetarësh me përvojë dhe plotësisht të pavarur nga çdo parti politike, grup interesash apo klane biznesi, me qëllim për të thënë çdo të vërtetë të guximshme me interes publik. ‘Prapaskena’ është një media e lirë dhe e pakompromis, e cila ka si qëllim informimin e opinionit publik në mënyrë të paanshme, profesionale dhe në dritën e të vërtetës, mbi çështje që lidhen me korrupsionin politik, krimin, pandëshkueshmërinë, grabitjen e pasurive publike, mbi reformat, sfidat kombëtare dhe lidhjet e padukshme mes partive politike, mediave të njësura me interesat klienteliste, krimit dhe biznesit jo të ndershëm, të cilët në bashkëpunim përvetësojnë paratë dhe pasuritë publike.’

Copyrights

Çdo kopjim, përdorim apo riprodhim i paautorizuar i këtij materiali është i ndaluar dhe mund të sjellë ndjekje ligjore. Ju lutemi respektoni punën dhe përpjekjen tonë duke mos e shkelur këtë parim.

Kategoritë

[KREU INVESTIGIM](#)

[KRIM & KORRUPSION](#) [DOSJE ROZË](#)

[KRYESORE](#) [POLITIKË](#) [EKONOMI](#)

[ANALIZË](#) [RAJON](#) [KULTURË](#) [SPORT](#)



Email: [\[email protected\]](#)

Copyright © 2025. All Rights Reserved by Prapaskena

[Privacy Policy](#) | [Cookies](#)